Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0577

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Naim Shuki B.I., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të ADMINISTRATA E QENDRËS - MINISTRIA E FINANCAVE,PUNËS DHE TRANSFEREVE në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me veshmbathje për stafin e terenit të DTP-së me numër të prokurimit 201.-23-7059-1-3-6, me 10/10/2023, mori:

Vendim

1. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik"Naim Shuki" B.I , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 14.08.2023 (me numër protokolli 577/23) vendimi i AK lidhur për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me veshembathje per stafin e terenit te DTP-se" me nr. të prokurimit:201-23-7059-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Administrata e Qendres – Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve, mbetet në fuqi.

2. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, sikurse parashihet me nenin 31 paragrafi 5, të Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, lidhur me nenin 118 të LPP.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 11.07.2023, Administrata e Qendres – Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me veshembathje per stafin e terenit te DTP-se" me nr. të prokurimit: 201-23-7059-1-3-6 Nderkaq me datën 25.07.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE“Naim Shuki”B.I me datën 31.07.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK-Administrata e Qendres – Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve me vendim ka refuzuar kërkesën per rishqyrtim te OE“Naim Shuki” B.Ilidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me veshembathje per stafin e terenit te DTP-se” me numër te prokurimit: 201-23-7059-1-3-6 inicuar nga – Administrata e Qendres – Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues“Naim Shuki” B.I me datën 14.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 577/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës:4.000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 17.08.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Naim Shuki” B.I.

- Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik“Naim Shuki” B.I , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 14.08.2023 (me numër protokolli 577/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me veshembathje per stafin e terenit te DTP-se” me nr. të prokurimit:201-23-7059-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Administrata e Qendres – Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve

- Të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e

kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në ketë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në raportin e ekspertit shqyrtues nuk janë dhenë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Prandaj Paneli nuk e mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili raportin e ekspertizës e ka shumë të mangët dhe pa përgjigje në pretendime ankimore. Kjo edhe në mungesë të prezantimit të provave nga pala ankimore. Eksperti shqyrtues në këtë rast ka marrë për bazë vetëm plotësimin e specifikave teknike sa i përket materialit të pambukut, këtë e ka argumentuar edhe përmes emailit në kërkesën e tij drejtuar OE ankues. Eksperti shqyrtues po ashtu nuk ka marrur për bazë edhe mos ofrimin e specifikave teknike për produktin 2, 3, 8 dhe 9.

Në bazë të Dosjes së Tenderit mund të shihet se janë kërkuar specifikimet teknike për 9 produkte, pa nevojë që ato të përmenden secila dhe sipas vlerësimit të AK, operatori ekonomik është eleminuar me këto arsye:

X Nuk keni ofruar dëshmi të mjaftueshme , siç është përshkruar në nenin 69 të LPP. Ju nuk i permbushni specifikimet teknike te detyrueshme te Aneksit 1 te AK sepse kerkese e AK ka qene qe per pozicionin nr 1.Maica me mëngë vereore te kene permbajtjen pambuk 100% ndersa ju keni ofruar maicat me permbajtje 50% Polyester dhe 50% Pambuk , per pozicionin nr .2 Kepuce per teren kodrinor –malor (ecje) per mashkuj , per pozicionin nr.3 Kepuce per teren kodrinor –malor (ecje) per femra, per pozicionin nr.8 Çantë shpine tereni dhe per pozicionin nr .9 Shishe uji nuk keni dorezuar specifikimet teknike per asnjeren nga pozicionet e lartecekura . Per arsyjet e lartecekura eshte refuzuar tenderi juaj.

Poashtu çmimet e ofertuara per disa pozicione duken se jane çmime mbi çmimet e tregut .

Kërkesë e Dosjes së Tenderit ka qenë që për këto produkte të ofrohen katalogjet dhe të njëjtit të jenë të nënvizuar për artikujt që oferton. OE ka sjellë një katalog i cili i ka vetëm fotot por brenda tij nuk ka ndonjë specifikim teknik, por i njëjti ka ofruar disa teste rreth specifikave të materialeve jo të produkteve konkrete, me të cilat parashihen të punohen këto produkte të kërkuara nga AK. Por të cilat nuk ofrojnë informacion të mjaftueshëm për secilin produkt. Mund të merret për bazë edhe konstatimi edhe i ekspertit shqyrtues se maicat do ta kenë materialin 100% pambuk sipas "atestit" të ofruar por për produktet tjera nuk identifikohen askund asnjë specifik tjetër, për të cilat është eleminuar OE ankues dhe eksperti shqyrtues nuk ka ofruar për panelin shqyrtues asnjë sqarim. Dhe si të tilla nuk mund të mbulohen vetëm me një deklaratë të

OE.

Andaj, paneli shqyrtues nuk e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim pa ndonjë provë apo argument, ngase OE ankues ka ofruar katalogje të cilat nuk i kanë specifikat teknike sipas Dosjes së Tenderit dhe këto ateste të cilat i ka ofruar "katalogje" nuk janë qartë të identifikuara për panelin shqyrtues se për cilin produkt bëhet fjalë dhe a përmbushen të gjitha specifikat. Kështu që konform nenit 10 të udhëzuesit nr. 01/2023 për Prokurim Publik, "Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara, atëherë Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm". Po ashtu edhe sa i përket pikës së fundit të eleminimit, sa i përket çmimit jo sipas tregut për disa pozicione, sqarimi i ofruar nga ankuesi nuk është i mjaftueshëm për panelin shqyrtues ashtu siç nuk ka qenë i mjaftueshëm as për AK, operatori ekonomik ka qenë dasht të ofroj argumente bindëse sa i përket çmimeve të ofruara dhe kualitetit të këtyre produkte.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara shkurtimisht si më sipër në shkresat e kësaj lënde nuk gjendet ndonjë provë se AK ka aplikuar ndonjë kriter apo veprim që diskriminon, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik.

Vërejtje për autoritetin kontraktues se specifikimet teknike të detyrueshme nuk janë të hartuara siç duhet dhe vlerësimi mbi bazën e këtyre specifikimeve teknike është shumë i vështirë dhe i pa matshëm. Do ta përmendim vetëm një shembull "Këpucë për teren të vështir kryesisht kodrinorë-malore të cilat ofrojnë rehati, stabilitet dhe mbështetje afatgjate, ku pjesa e sipërme e bërë me një kombinim lëkure sintetike dhe rrjetë që merr frymë, sistem i gjerë i lidhëses, sistemi i këmbëve i bërë me 5% përmbajte gome të ricikluar, të ketë njësim Vectivim e cila është e krijuar për të ndihmuar në maksimizimin e energjisë në shteg". Kështu që, nëse AK shpreh interes që këtë aktivitet të prokurimit ta ri-tenderoj atëherë specifikimet teknike duhet të bëhen si duhet dhe të sakta dhe lehtë të verifikueshme (eventualisht me ndonjë devijim me një përqindje të vogël), sepse edhe pranimi i tyre pas kontraktimit mund të jetë shumë i vështirë. Po ashtu të bëjë edhe një hulumtim të tregut sa i përket vlerës së parashikuar të këtij aktiviteti të prokurimit.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”..

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në ketë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka

parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **ADMINISTRATA E QENDRËS - MINISTRIA E FINANCAVE,PUNËS DHE TRANSFEREVE**
- OE - **Naim Shuki B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: